



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:278176

Datë: 21.02.2025

Numri i dokumentit: 06881893

C.nr.4853/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtorin profesional Y.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësve Gj.D., M.A., A.I., E.H. dhe M.S. që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim përfaqëson av. A.S. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti padi për kompensim sipas shkallës së inflacionit, jashtë shqyrtimit gjyqësor, më datë **11.02.2025**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

(Pa shqyrtim kryesor të çështjes)

I.APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve **Gj.D., M.A., A.I., E.H. dhe M.S.** me të cilën **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Arsimit që në emër të kompensimit në pagë konform shkallës së inflacionit, të paguajë shumat dhe atë:

- Për paditësen **Gj.D.** për periudhën kohore 01.12.2020 – 21.11.2022, shumën prej 695.98 euro;
- Për paditësen **M.A.** për periudhën kohore 01.12.2020 – 21.11.2022, shumën prej 695.98 euro;
- Për paditësin **A.I.** për periudhën kohore 01.12.2020 – 21.11.2022, shumën prej 695.98 euro;
- Për paditësin **E.H.** për periudhën kohore 01.12.2020 – 21.11.2022, shumën prej 695.98 euro;
- Për paditësin **M.S.** për periudhën kohore 01.12.2020 – 21.11.2022, shumën prej 695.98 euro.

Të gjitha këto në shumë totale **3,479.90€**, deri në pagesën definitive, duke e llogaritur me kamatë ligjore prej 8% prej ditës së paraqitjes së padisë (13.12.2023), në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II.REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, përtej shumës së gjykuar si nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi deri në shumën e kërkuar prej 3,594.75

euro, përkatësisht shuma prej **114.85 €**, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagë.

III.OBLIGOHET e paditura, që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë shumën prej 352.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate me 15.12.2023, kanë parashtruar padi kundër Komunës së Prizrenit, Drejtoria e Arsimit, me të cilën kanë kërkuar kompensim në pagë, lidhur shkallën e inflacionit, nga data 01.01.2020, deri më 21.11.2022, konkretisht për paditësen për paditësin Gj.D. shumën prej 718.95 euro, për paditësen M.A. shumën prej 718.95 euro, për paditësin A.I. shumën prej 718.95 euro, për paditësin E.H. shumën prej 718.95 euro, si dhe për paditësin M.S. shumën prej 718.95 euro, në shumën e përgjithshme 3,594.75. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar në shumën prej 624 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 24.04.2024, ku ka theksuar se kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i pagave jubilarë është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, paditësit në padi nuk kanë paraqitur fakte se janë anëtare e sindikatës së arsimit – SBASHK, paditësit kanë ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedurën administrative, nuk i kanë vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, ashtu që paditësit nuk i kanë shtjerrur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative dhe janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 paragrafi 6.1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/031. Pretendimet e paditësve se i takojnë beneficionet nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate, poashtu në fund është theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit prej vitit 2020 është parashkruar sepse kanë kaluar mbi 3 vite, nga të lartcekurat e paditura ka propozuar gjykatës që të refuzohet kërkesëpadija e paditësve Gj.D., M.A., A.I., E.H. dhe M.S. si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se që të gjithë paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës në SHFMU. “Mati Logoreci”, në Prizren.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimi me numër 45/22 të datës 21.02.2022, lëshuar nga SH.F.M.U “Mati Logoreci”- Prizren, për paditësen M.A. vërtetimi me numër 45/22 të datës 21.02.2022, lëshuar nga SH.F.M.U “Mati Logoreci”- Prizren, vërtetimi me numër 45/22 të datës 21.02.2022 për paditësin A.I. lëshuar nga SH.F.M.U “Mati Logoreci”- Prizren, vërtetimi me numër 45/22 të datës 21.02.2022 për paditësin E.H. lëshuar nga SH.F.M.U “Mati Logoreci”- Prizren, vërtetimi me numër 45/22 të datës 21.02.2022 për paditësin M.S. lëshuar nga SH.F.M.U “Mati Logoreci”- Prizren, vërtetimi me numër 45/22 të datës 21.02.2022 për paditësen Gj.D. lëshuar nga SH.F.M.U “Mati Logoreci”- Prizren, të gjitha këto vërtetime janë lëshuar nga e paditura, me të cilat vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, në SH.F.M.U “Mati Logoreci”- Prizren.

Bazuar në vërtetimet e lëshuara nga e paditura, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësve është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 datë 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.12.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 0.84 euro ($421 * 0.2\% = 0,84 * 1 \text{ muaj} = 0.84 \text{ euro}$).

- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021

ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.76 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 12 \text{ muaj} = 171.76 \text{ euro}$).

- Për periudhën 01.01.2022 deri me dt. 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.54 euro ($421 * 11.6\% = 48.83 * 10 \text{ muaj} \text{ e } 21 \text{ ditë} = 522.54 \text{ euro}$).

- Apo në shumën e përgjithshme prej 695.98 euro për secilin paditës, për periudhën 01.12.2020 deri me dt. 21.11.2022, në shumën e përgjithshme prej 3,479.90€.

Duke u bazuar në dispozitat të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, si dhe dispozitave tjera ligjore dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e aprovoj në mënyrë të pjesshme kërkesëpadinë e paditësve sa i përket kompensimit të pagës në pajtim me shkallën e inflacionit ndër vite, duke llogaritur pagën bazë në shumën prej 421 euro, ashtu që, u ka njohur paditësve shumat, konkretisht për paditësen Gj.D. për periudhën kohore 01.12.2020 – 21.11.2022, shumën prej 695.98 euro, për paditësen M.A. për periudhën kohore 01.12.2020 – 21.11.2022, shumën prej 695.98 euro, për paditësin A.I. për periudhën kohore 01.12.2020 – 21.11.2022, shumën prej 695.98 euro, për paditësin E.H. për periudhën kohore 01.12.2020 – 21.11.2022, shumën prej 695.98 euro, për paditësin M.S. për periudhën kohore 01.12.2020 – 21.11.2022, shumën prej 695.98 euro. Të gjitha këto në shumë totale 3,479.90€, deri në pagesën definitive, duke e llogaritur me kamatë ligjore prej 8% prej ditës së paraqitjes së padisë (13.12.2023), në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 13.12.2023 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.12.2020 e deri më 31.10.2022, gjykata konstaton se parashkrimi për kërkesën e paditësit për tetor 2020 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që të njëjtit kanë pranuar pagën e nëntorit 2020, e cila pagë realizohet në fund të muajit rrjedhimisht të njëjtit atëherë janë njoftuar se e paditura nuk ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin nëntor 2020 dhe nga fillimi i muajit vijues saktësisht dhjetor 2020, të njëjtit kanë mundur të kërkojnë përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, ku parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”* rrjedhimisht këtu paditësve nga fillimi i dhjetorit 2020 kanë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga këtu e paditura, e që nënkupton se padia e paditëses për periudhën 01.12.2020 e deri më 21.11.2022, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të LP-së, ku sipas këtij neni *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 13.12.2022, paditësit e kanë ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe

e kanë ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë respektivisht nga data 13.12.2022.

Po ashtu gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, përtej shumës së gjykuar si nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi deri në shumën e kërkuar prej 3,594.75 euro, përkatësisht shumën prej 114.85 €, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagë, sepse nga vërtetimet e lëshuara nga e paditura vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësve është shuma prej 421.00 euro, pasi që Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 dhe njëjta ishte në fuqi deri me datën 22.11.2022.

Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën nën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Sa i përket kundërshtimeve të tjera të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (13.12.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 40.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 352.00 euro. Gjykata, e refuzoj pjesën tjetër të kërkesës sa i përket shpenzimeve të procedurës në shumë prej 272 euro, ashtu që lidhur me shpenzimet u vendos si në dispozitivit III të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
-Departamenti i përgjithshëm-
C.nr.4853/23, datë 11.02.2025

G j y q t a r i
Shaban Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate